



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government
Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice
Departamenti për Profesione të Lira-Departmant Slobodnih Profesija- Department of
Freelance Professions

Komisioni Disiplinor/Disiplinska Komisija/The Disciplinary Comitee

DPL.nr. 02/2022

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARUESIT PRIVAT, në përbërje nga Adnan Isufi, kryesues, znj. Diellza Hoxha dhe z. Rushit Hoxha, anëtarë të komisionit disiplinor, në çështjen disiplinore ndaj përmbaruesit privat z. _____ si organ përmbarues i emëruar nga Ministria e Drejtësisë e Republikës së Kosovës (tash e tutje Ministria e Drejtësisë) për Territorin e Gjykatës Themelore në _____, pas mbajtjes së seancën dëgjimore publike në të cilën prezantuan përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, znj. Burbuqe Spahija Kërveshi, në cilësi të iniciuesit të procedurës disiplinore, përmbaruesi privat, z. _____ dhe përfaqësuesi i tij sipas autorizimit Av. _____ si dhe z. _____ përfaqësues i kompanisë “ _____”, Sh.p.k, me seli në _____ në cilësi të palës ankuese, dhe pas seancës këshillimore, me datën 01.03.2022, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHEN Raporti përfundimtar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira- Divizioni për Noterinë dhe Përmbarimin Privat, DPL-02/2022, datë 21.01.2022, si dhe ankesa e z. _____ përfaqësues i kompanisë “ _____”, Sh.p.k, me seli në Fushë Kosovë, dt 12.01.2022, si të pabazuara.

A R S Y E T I M

Me datën 12.01.2022, pala ankuese z. _____, përfaqësues i kompanisë “ _____”, Sh.p.k, me seli në Fushë Kosovë, ka paraqitur ankesë në Ministrinë e Drejtësisë - Departamentin për Profesione të Lira - Divizionin për Noterinë dhe Përmbarimin Privat ndaj përmbaruesit privat z. _____. Pala ankuese pretendon se përmbaruesi privat z. _____ ka kryer një varg shkeljes ligjore. Sipas palës ankuese, përmbarimi është lejuar sipas urdhrit përmbarimor P. nr 430/2021 me të cilën është urdhëruar pala debitore “ _____” Sh.p.k. që në afat prej shtatë (7) ditësh nga dita e pranimit të urdhrit t’i paguajë palës kreditore “Uni Trade” Sh.p.k, shumën prej tridhjetë e katër mijë e katër dhjetë e gjashtë euro e tridhjetë cent (34.046.30 €), me kamatë vonesë prej tetë (8 %) përgjind në vit nga dita e lejimit të këtij propozimi deri në pagesën definitive si dhe

shpenzimet e procedurës përbarimore. Pala ankuese pretendon se përbaruesi privat z.

ka bllokuar llogaritë bankare pa i njoftuar fare dhe pa i ndjekur procedurat ligjore. I njëjti, sipas palës ankuese, nuk ka bërë tentim thirrje për dorëzimin e urdhrin përbarimor palës debitore me arsyetimin se me datën 03.12.2021 përmes postës ka tentuar që ta njoftojë palën debitore por kjo nuk ka ndodhur përkundër që kompania “ ” sh.p.k ka të njëjtën adresë Zona Industriale Fushë Kosovë – Prishtinë me nr 261 me një tablo reklamuese 15 metra. Pala ankuese thekson se me datën 31.12.2021, i është drejtuar gjykatës me kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme megjithatë deri tani nuk janë informuar lidhur me kërkesën. Rrjedhimisht, pala ankuese kërkon ndërmarrjen e veprimeve ligjore ndaj përbaruesit privat z. në mënyrë që i njëjti të obligohet të liron llogaritë.

Me datën 21.01.2022, Ministria e Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përbarimin Privat, pas shqyrtimit të çështjes ka paraqitur në Komisionin Disiplinor Raportin Përfundimtar ndaj përbaruesit privat z. , si organ përbarues i emëruar për Territorin e Gjykatës Themelore në , lidhur me veprimet e ndërmarra në lëndën e lartpërmendur përbarimore.

Përbaruesi privat në përgjigjen e tij me shkrim thekson se pretendimet për shkelje disiplinore janë të pabazuara. Për sa i përket dërgimit të shkresave, përbaruesi privat thekson se urdhri i është dorëzuar palës ankuese përmes postes me rekomand në adresën zyrtare dhe fletë kthesa është kthyer me konstatimin “adresa është e panjohur.” Pas hulumtimit në regjistrin e Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës (ARBK), kanë siguruar adresën e palës debitore dhe në atë adresë kanë dorëzuar urdhrin përbarimor. Megjithatë, përsëri dorëzimi i urdhrin ka rezultuar i pasuksesshëm. Pasi gjitha përpjekjet për dorëzimin e urdhrin përbarimor kishin rezultuar të pasuksesshme, përbaruesi privat thekson se ka lëshuar urdhër për afishimin e urdhrin përbarimor në tabelën e shpalljeve. Rrjedhimisht, përbaruesi privat kërkon refuzimin e ankesës si të pabazuar.

Me datën 01.03.2022, Komisioni Disiplinor ka mbajtur seancë dëgjimore në të cilën kanë marr pjesë përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë - Departamenti për Profesione të Lira - Divizioni për Noterinë dhe Përbarimin Privat, znj. Burbuqe Spahija - Kërveshi, përbaruesi privat, z. dhe përfaqësuesi i autorizuar i përbaruesit privat Av. si dhe z. përfaqësuesi i autorizuar i kompanisë “ ”, Sh.p.k, me seli në .

Përfaqësuesi i autorizuar i Ministrisë së Drejtësisë ka bërë shtjellimin e Raportit Përfundimtar duke theksuar se mbetet pranë të njëjtit. Po ashtu, përbaruesi privat z. dhe përfaqësuesi i autorizuar i tij Av. si dhe përfaqësuesi i autorizuar i palës ankuese z. kanë ngelur pranë ankesës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitura me shkrim dhe kanë bërë eleborimin e tyre.

Komisioni me kujdes, vëmendje të veçantë dhe në mënyrë shteruese ka çmuar çdo provë të administruar në seancën dëgjimore veç e veç dhe të gjitha ato së bashku dhe pas analizimit, vlerësimit dhe peshimit të tyre, vjen në përfundim se përbaruesi privat z. nuk ka kryer shkelje disiplinore.

Komisioni Disiplinor gjen se, në rastin konkret, pala ankuese z. [] pretendon, në thelb, që nuk ka pranuar urdhrin përmbartimor. Sipas palës ankuese, ai nuk ka pranuar urdhrin përmbartimor edhe pse përmbartuesi privat z. [] thekson se datën me datën 03.12.2021 ka tentuar që ta njoftoj përmes postës palën debitorë. Kjo, sipas palës ankuese realisht nuk ka ndodhur. Pala ankuese thekson që kompania [] sh.p.k, ka adresën në Zonën Industriale [] – Prishtinë me nr 261 me një tablo reklamuese 15 metra. Rrjedhimisht, pala ankuese pretendon që adresa është lehtë e identifikueshme. Pala ankuese thekson se me datën 31.12.2021, i është drejtuar gjykatës me kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme, megjithatë, deri tani nuk janë informuar lidhur me kërkesën. Rrjedhimisht, pala ankuese kërkon ndërmarrjen e veprimeve ligjore ndaj përmbartuesit privat z. [] në mënyrë që i njëjti të obligohet t’ia liron llogaritë.

Për sa i përket dërgimit të urdhrin përmbartimor palës ankuese, Komisioni Disiplinor gjen se përmbartuesi privat megjithatë kishte dërguar atë në adresën e palës ankuese përmes Postës së Kosovës. Kjo evidentohet mbi bazën e fletë kthesës rekomand R-1947865 nga Posta e Kosovës, mbi bazën e së cilës është konstatuar se “adresa është e panjohur.” Gjithashtu, përmbartuesi privat kishte bërë përpjekje të siguron adresën e palës ankuese në të dhënat e Agjencionit për Regjistrimin e Bizneseve të Kosovës. Saktësisht në adresën e palës ankuese cila është e regjistruar në të dhënat e ARBK-së ishte dërguar urdhri përmbartimor P. nr 430/21 i datës 24.11.2021. Megjithatë, përpjekja për dorëzimin e urdhrin përmbartimor përsëri kishte rezultuar e pasuksesshme. Komisioni Disiplinor vlerëson se fakti se rrugët shpesh nuk përmbajnë emra dhe numra të saktë të adresave, nuk mund t’i atribuohen përmbartuesit privat si lëshime. Fletë kthesat nga Posta e Kosovës ku është konstatuar “adresa e panjohur” janë lëshuar nga organi zyrtar - Posta e Kosovës. Përmbartuesi privat z. [] ishte mbështetur në konstatimet e organeve zyrtare. Përndryshe, nuk ka ndonjë arsye tjetër, bazuar në shkresat e lëndës, për mos dorëzimin e urdhrin përmbartimor palës ankuese. Pasi që pala ankuese ishte paraqitur tek përmbartuesi privat, ky i fundit i kishte ofruar gjithë dokumentacionin, përfshirë urdhrin përmbartimor si dhe kishte njoftuar palën ankuese lidhur me mjetin juridik. Pala ankuese veçse ka adresuar pretendimet e saj ligjore pranë gjykatës kompetente përmes shfrytëzimit të mjeteve juridike në dispozicion duke parashtruar kërkesë për kthim në gjendjen e mëparshme pranë gjykatës kompetente. Derisa procedura sipas mjetit juridik është në zhvillim e sipër, Komisioni Disiplinor është i kufizuar të jap ndonjë vlerësim. Procedurat disiplinore pranë komisionit disiplinor nuk janë procedura shtesë të procedurave gjyqësore apo zëvendësuese të tyre ku palën adresojnë përsëri ato pretendime ligjore të cilat kanë ngritur në gjykatën përkatëse. Rrjedhimisht, Komisioni vlerëson se pretendimi i palës ankuese është i pabazuar.

Nga sa u tha më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KOMISIONI DISIPLINOR PËR PËRMBARTUESIT PRIVAT
DPL.nr 02/2022, datë 01.03.2022

Kryesues i Komisionit Disiplinor
Adnan ISUFI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë të hap konflikt administrative bazuar në nenin 374 par 5 të LPP-së.

1. The first part of the document is a list of names and addresses.

2. The second part of the document is a list of names and addresses.

3. The third part of the document is a list of names and addresses.

4. The fourth part of the document is a list of names and addresses.

5. The fifth part of the document is a list of names and addresses.

6. The sixth part of the document is a list of names and addresses.

7. The seventh part of the document is a list of names and addresses.

8. The eighth part of the document is a list of names and addresses.

9. The ninth part of the document is a list of names and addresses.

10. The tenth part of the document is a list of names and addresses.

11. The eleventh part of the document is a list of names and addresses.

12. The twelfth part of the document is a list of names and addresses.

13. The thirteenth part of the document is a list of names and addresses.

14. The fourteenth part of the document is a list of names and addresses.

15. The fifteenth part of the document is a list of names and addresses.

16. The sixteenth part of the document is a list of names and addresses.

17. The seventeenth part of the document is a list of names and addresses.

18. The eighteenth part of the document is a list of names and addresses.

19. The nineteenth part of the document is a list of names and addresses.

20. The twentieth part of the document is a list of names and addresses.

21. The twenty-first part of the document is a list of names and addresses.

22. The twenty-second part of the document is a list of names and addresses.